

ARGUMENTUM



news opinion analysis



**Kryeministri Rama
i përgjigjet Greqisë në
gjuhën e tyre: Νόμω πείθου**

BINDJU LIGJIT!

- Në Lin të Pogradecit
zbulohet vendbanimi
më i vjetër në Europë

- A është përsëri zgjerimi në
agjendën e BE-së?

- Der Spiegel: "Vuçiç,
zjarrvënës i Ballkanit"

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 JO VETEM LAJMI

- Kryeministri Rama i përgjigjet Greqisë në gjuhën e tyre: Νόμος πείθου* – Bindju ligjit*.

07 POLITIKË

- Shqipëria sërish në krye të Këshillit të Sigurimit në OKB: Vendi ynë merr më 1 shtator për herë të dytë presidencën.

08 FOKUS

- Në Lin të Pogradecit zbulohet vendbanimi më i vjetër në Europë.

- A është përsëri zgjerimi në agjendën e BE-së?

11 REALPOLITIK

- Paqja vetëm dëshirore! Ndryshoni kursin! Kambanat e Brukselit bien për Tiranën! Beleri midis Tiranës, Brukselit dhe Athinës! Të krahasosh të pakrahasueshmet!

14 RAJONI

- Athinë, liderët e Ballkanit me deklaratë të përbashkët: Vendi i Ballkanit Perëndimor është në BE!

- Der Spiegel: “Presidenti i Serbisë Vuçiç, zjarrvënësi i Ballkanit”.

17 BOTA

- BRICS zgjerohet me gjashtë anëtarë të rinj, duke përfshirë Argjentinën, Iranin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabinë Saudite, Etiopinë dhe Egjiptin.

ENGLISH EDITION

19 ENGLISH TOP NEWS

- PM Rama sees Beleri as equal before the law in Albania.

- Balluku announces that the oil in Shpirag is at a depth of over 6 km, 15 wells will be opened.

21 IN FOCUS

- August 8, 1991, marked 32 anniversary of the exodus of Albanians to Italy.

- US provides anti-terrorism equipment and training to the Albanian police.

23 REALPOLITIK

- Peace as wishful thinking! Change the course! Brussels bells toll for Tirana! Beleri between Tirana, Brussels and Athens! Compare the incomparables!

26 BALKAN OVERVIEW

- Refusal of entry in Serbia for former deputy PM and FM of Montenegro Marović sparks strong reaction of international organizations and official Podgorica.

- Osmani responds to French president saying that suspending the decision on visas would.

- Political deadlock in effort to adopt constitutional changes in North Macedonia.

Kryeministri Rama i përgjigjet Greqisë në gjuhën e tyre:

Νόμω πείθου* BINDJU LIGJIT*



Kryeministri Edi Rama reagoi pas protestave më 14 gusht në Himarë për lirimin e kryebashkiakut të zgjedhur të Himarës, Fredi Bleri. Mes protestuesve ishin të pranishëm edhe kryebashkiaku i Athinës dhe Selanikut, duke e bere kete proteste te papcredente për një vend anëtar të Bashkimit European si Greqia.

Në një koment të gjatë, Rama kujtoi se prej disa muajsh politikanë dhe medie të caktuara në Greqi, kërkojnë nga Shqipëria

Rama e nis komentin me thënien që i atribuohet Shtatë të Urtëve të Greqisë, “Bindju Ligjit”, ndërsa theksoi se “Greqia njësoj si vendet e tjera të Bashkimit European e ka mbështetur Reformën në Drejtësi në Shqipëri pa asnjë rezervë.

që të lirojë nga burgu kryebashkiakun e zgjedhur të Himarës.

Rama e nis komentin me thënien që i atribuohet Shtatë të Urtëve të Greqisë, “Bindju Ligjit”, ndërsa theksoi se “Greqia njësoj si

vendet e tjera të Bashkimit European e ka mbështetur Reformën në Drejtësi në Shqipëri pa asnjë rezervë.

“Po kush dhe si mund ta lirojë sot nga burgu një qytetar shqiptar

me kombësi greke, i cili si kandidat për kryetar bashkie, akuzohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit e Krimin të Organizuar, se ka kryer krimin e blerjes së votave – për të cilin Kodi Penal i Shqipërisë është i qartë dhe drastik – ndërsa sipas vendimit të pandryshuar në të treja shkallët e gjykimit, nuk mund ta lerë paraburgimin deri në fund të procesit gjyqësor ndaj tij?!” theksoi ai.

Po ashtu, Rama theksoi se “Shqipëria e sotme është një vend europian me një legjislacion të ri shembullor për të gjitha minoritetet, ku minoriteti grek gëzon liri e të drejta të njëjta me bashkësinë shqiptare, ku qytetarët tanë me kombësi greke zgjedhin e zgjidhen lirisht, siç ndodhi edhe në zgjedhjet bashkiake të këtij viti në Dropull e në Finiq”.

Komenti i plotë i

Kryeministrit të Shqipërisë:

Νόμος πείθου* – **Bindju ligjit***

U bënë disa muaj që politikanë dhe media të caktuara në Greqi, kërkojnë nga Shqipëria që të lirojë nga burgu kryebashkiakun e zgjedhur të Himarës. Përpara pak javësh, Margaritis Schinas, zëvendës president i Komisionit Europian dhe mik i mirë i Shqipërisë, publikoi një letër drejtuar komisionerit Oliver Varheley. Me një ton diplomatikisht paralajmërues për pengimin e ecurisë së negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian, i kërkoi kolegut të tij të ndërhyjë pranë autoriteteve shqiptare, sepse përndryshe ai, pra zoti Schinas, sheh “një rrezik imediat që kjo çështje të ndikojë negativisht në raportin e progresit të 2023 për Shqipërinë dhe angazhimin e saj në promovimin e

Vallë kombësia greke i jep qytetarit shqiptar të akuzuar nga SPAK-u dhe mbajtur në paraburgim nga gjykatat e vendit, një status të ndryshëm nga 48 qytetarë të tjerë shqiptarë me kombësi shqiptare, ndër të cilët edhe disa kryebashkiakë të partisë time, që sot janë të paraburgosur nën akuzat e të njëjtit organ, me vendime identike të të njëjtave gjykata?!

rendit ligjor”.

Në këto terma dhe me bindjen e njëjtë si në letrën e lartpërmendur, edhe mbi “lidhjen e kësaj çështjeje me respektin e përgjithshëm për të drejtat themelore apo çështjen e mbetur pezull të pronave të minoritetit grek në zonën e bashkisë në fjalë, si edhe me akuzat për shkelje të kufijve të tyre nga ana e shtetit”, siç shkruhej në letrën e zotit Schinas, u zhvillua dje një protestë e organizuar nga politikanë grekë në qendër të Himarës!

(Ç’është e vërteta kjo bindje e miqve grekë nuk bazohet në as edhe një fakt konkret, që do të mund të provonte se në Shqipëri ka vërtetë një problem specifik të drejtash apo pronash për minoritetin grek, i cili ndryshon nga problemi tërësor i trashëguar i Shqipërisë me pronat e gjithë qytetarëve shqiptarë, çka edhe e kemi trajtuar e do ta trajtojmë vijimisht me respekt, me durim dhe me gjuhën e fakteve me Athinën zyrtare).

Në memorien time nuk ka një rast tjetër, kur të zgjedhurit e një shteti demokratik organizojnë protestë në një shtet tjetër demokratik, kundër autoriteteve të këtij shteti. Jo vetëm kaq, po ku ata shfaqen si protestues kundër vendimeve të gjykatave përkatëse të shtetit në të cilin protestojnë, duke e absolutizuar përkatësinë etnike të subjektit të protestës mbi çdo normë juridike, standard ligjor e logjikë demokratike. Kjo është një nga ato situata tipike, kur shprehja “Jam pa fjalë!” është e para që të vjen në mend dhe do të doje të ndaleshe me aq. Por kjo është edhe një nga ato situata tipike, kur në Ballkan merr jetë ajo shprehja “Digjet jorgani për një plesht!” prandaj edhe duhet folur e bërë çmos, që ky të mos jetë kurrësesi rasti.

“Lironi Belerin dhe pikël”.

Po kush dhe si mund ta lirojë sot nga burgu një qytetar shqiptar me kombësi greke, i cili si kandidat për kryetar bashkie, akuzohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit e Krimin të Organizuar, se ka kryer krimin e blerjes së votave – për të cilin Kodi Penal i Shqipërisë është i qartë dhe drastik – ndërsa sipas vendimit të pandryshuar në të treja shkallët e gjykimit, nuk mund ta lerë paraburgimin deri në fund të procesit gjyqësor ndaj tij?!

Vallë kombësia greke i jep qytetarit shqiptar të akuzuar nga SPAK-u dhe mbajtur në paraburgim nga gjykatat e vendit, një status të ndryshëm nga 48 qytetarë të tjerë shqiptarë me kombësi shqiptare, ndër të cilët edhe disa kryebashkiakë të partisë time, që sot janë të paraburgosur nën akuzat e të njëjtit organ, me vendime identike të të njëjtave gjykata?!

Unë nuk e kam fshehur men-

dimin tim shumë pozitiv, e as ndjenjat e mia shumë miqësore për kryeministrin Mitsotakis. Tek ai kam parë qysh në fillim një lider modern european dhe kam gjetur në vazhdimësi një njeri të admirueshëm. Nuk kam ndërmend t'i fsheh mendimin e ndjenjat e mia as sot, kur kolegut të nderuar e mikut tim të dashur Kyriakos, do t'i duhet të lexojë opinionin tim të mirëformuar dhe të mirinformuar, i cili nuk përkon gjëkund me opinionin e miqve protestues.

Për mua, ky politizim i një çështjeje të drejtësisë shqiptare, deri në pikën që të organizohet një protestë këtu në Shqipëri nga autoritete të zgjedhura në Greqi, ndër të cilët as më shumë e as më pak, po edhe kryebashkiakët e dy qyteteve më të mëdha të Greqisë, mund t'i shkonte skenarit të një filmi sarkastik për marrëdhëniet ndërshtetërore në një Ballkan të denjë për stereotipin e vet të vjetër të përplasjeve “kush jam unë e kush je ti!”, po jo realitetit demokratik të fqinjësisë europiane, mes një vendi anëtar të BE-së dhe një vendi që aktualisht negocion anëtarësimin në BE.

Unë nuk kam ndërmend ta fsheh në këto radhë as kënaqësinë për progresin e jashtëzakonshëm, që së bashku me kryeministrin grek kemi bërë në vitet e fundit, për t'i shkriur me frymë europiane akujt ballkanikë që ishin krijuar ndër vite në marrëdhëniet shqiptaro-greke, duke e parë njëri-tjetrin në sy dhe duke i adresuar me mendje të hapur e vullnet të mirë ngërçet e vjetra.

Por s'kam se si e fsheh edhe keqardhjen e madhe, përballë shfaqjes surreale të ndërhyrjes së palës greke në një çështje të drejtësisë shqiptare, deri në pikën që deklaratat nga Athina dhe përçapjet e miqve tanë grekë në Bruksel, për ta paraqitur këtë çështje të trajtuar gjermëtash nga drejtësia për akuzën e krimit elektoral, si një çështje të të drejtave të të minoritetit grek, përshkallëzohen me një protestë të kësaj natyre, të pashoqe në historinë e Europës – të paktën në dijeninë time!

jtësisë shqiptare, deri në pikën që deklaratat nga Athina dhe përçapjet e miqve tanë grekë në Bruksel, për ta paraqitur këtë çështje të trajtuar gjermëtash nga drejtësia për akuzën e krimit elektoral, si një çështje të të drejtave të të minoritetit grek, përshkallëzohen me një protestë të kësaj natyre, të pashoqe në historinë e Europës – të paktën në dijeninë time!

Jam jo vetëm shumë i keqardhur, por edhe seriozisht i shqetësuar. Sepse ky hap i hedhur si këmba e elefantit në një dyqan qelqurinash, mund të sjellë pasojën regresive të rindezjes së flamës së nacionalizmit, e të ndjenjave negative reciproke që ajo flamë lind në shtresa të keqinformuara



Kryeministri i Shqipërisë,
Edi Rama

s'kam se si e fsheh edhe keqardhjen e madhe, përballë shfaqjes surreale të ndërhyrjes së palës greke në një çështje të drejtësisë shqiptare, deri në pikën që deklaratat nga Athina dhe përçapjet e miqve tanë grekë në Bruksel, për ta paraqitur këtë çështje të trajtuar gjermëtash nga drejtësia për akuzën e krimit elektoral, si një çështje të të drejtave të të minoritetit grek, përshkallëzohen me një protestë të kësaj natyre, të pashoqe në historinë e Europës – të paktën në dijeninë time!

e në grupe të caktuara ekstremistësh, të cilët i mezipresin këto raste me bidon benzine në dorë, gjë që as nuk e dyshoj një sekondë se jo vetëm unë dhe qeveria shqiptare, po as kryeministri dhe qeveria greke nuk e dëshirojnë hiç asfare.

Ngado që rrotullohem për t'u futur “në këpucët e tjetrit”, unë nuk e gjej dot një rrugë që më nxjerr në shtegun e justifikimit të kësaj qasjeje ndaj një çështjeje të drejtësisë dhe nuk e kuptoj dot, se si mund të zgjidhet ky hall “i çuditshëm” i fqinjëve dhe miqve tanë, përveçse duke e lënë drejtësinë të bëjë e patrazuar punën e saj!

Prandaj nuk e di se çfarë mund të them tjetër, sepse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; ndarja e qartë e pushteteve, e cila falë Reformës në Drejtësi (Greqia njësoj si vendet e tjera të Bashkimit European e ka mbështetur reformën pa asnjë rezervë) dhe vullnetit të hekurt të shumicës sonë qeverisëse për ta zbatuar atë, pa bërë asnjëherë komente politike mbi vendimet e gjykatave, po i jep një përmasë të munguar në historinë e shtetit të saj, Shqipërisë demokratike në rrugën drejt Familjes së Bashkuar Europiane; vetë standarti i panegociueshëm i Bashkimit European, për të mos u përzier kurrësesi në punët e gjyqësorit për çfarëdo arsyeje politike; po edhe vizioni e vullneti im për të mos i kompromentuar kurrë marrëdhëniet e jashtme strategjike, me fryrjen e ndodhive episodike si kjo, ma bëjnë të pamundur të përsiatem më shumë mbi këtë episod sa banal, aq edhe të rrezikshëm brenda suazës së të menduarit ngushtësisht ballkanik.

Por miqve grekë, që erdhën

në Himarë në mes të pushimeve dhe dhanë shfaqjen e tyre unikalë edhe për turistët nga tërë Europa, që këtë vit kanë zbarkuar më të shumtë se kurdoherë në bregdetin shqiptar, u them se janë gjithnjë të mirëseardhur në Shqipëri.

Edhe për të protestuar po të duan!

Sepse Shqipëria e sotme është një vend evropian, tolerant me çdo protestues bashkëkohor, po edhe historikisht mikpritës për çdo të huaj, pa dallim ngjyre, gjuhe e feje, e për këtë dëshmojnë plot momente të historisë sonë, kur shqiptarët u bënë ëngjëjt mbrojtës të të huajve në luftë për mbijetesë, që nga ebrejtë gjatë Luftës së Dytë e deri tek afganët në ditët tona – përfshirë edhe grekët e goditur nga varfëria ekstreme në veriun e vendit të tyre gjatë luftës së përgjakshme civile, të cilët trokitën të rraskapitur në dyert e familjeve shqiptare në juglindjen e vendit tonë.

Jo vetëm kaq, po Shqipëria e sotme është një vend evropian me një legjislacion të ri shembullor për të gjitha minoritetet, ku minoriteti grek gëzon liri e të drejta të njëjta me bashkësinë shqiptare, ku qytetarët tanë me kombësi greke zgjedhin e zgjidhen lirisht, siç ndodhi edhe në zgjedhjet bashkiake të këtij viti në Dropull e në Finiq, pas një fushate elektorale me mesazhet e dhëna shqip e greqisht (edhe nga unë vetë madje, që fatkeqësisht nuk e flas gjuhën e mrekullueshme greke); ku flamuri grek u valëvit lirisht mes këngëve e valleve tradicionale dropullite dhe kandidatët e minoritetit grek morën mandatet për të vazhduar të qeverisin të patrazuar komunitetet e tyre; ku në periudhën e qeverisjes time, familjeve greke u janë

legalizuar masivisht shtëpitë e ndërtuara pa leje në vitet e tranzicionit, e u janë dhënë me mijëra tituj pronësie të mohuar me dekada, ashtu sikundër u janë dhënë kishave, ku besimtarët ortodoksë kryejnë ritualet fetare, titujt e pronave të rrëmbyera nga regjimi komunist, të paregjistruara deri kur unë erdha në qeveri.

Medieve greke që merren me çështjen që u bë shkak për këta rreshta, u them se janë të mirëpritura ta dëgjojnë edhe këmbanën tjetër nëse dëshirojnë, kur të dëshirojnë, në Tiranë apo edhe në Himarë po të duan, ku i presim gjithnjë me kënaqësi me të vërtetat tona!

Sepse Shqipëria sot, ka një qeveri që thotë atë që bën dhe bën atë që thotë, si për çdo gjë tjetër edhe për të drejtat e për pronat e anëtarëve të minoritetit grek. Të cilat, kurrë, në asnjë rast, nuk janë trajtuar nga autoritetet e sotme shqiptare ndryshe nga ato të të gjithë shqiptarëve.

Lëmshi i titujve të pronësisë në Shqipëri ka qenë një sëmundje e keqe e krijuar nga komunizmi dhe e përkeqësuar deri në agoni nga tranzicioni demokratik, gjatë të cilit pronat u bënë për vite të tëra objekt i një papërgjegjshmërie të neveritshme të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Prandaj edhe ne kemi pasur një vëmendje të veçantë për të drejtën pronësore dhe procesi i vonuar me dekada i trajtimit të pronave në zona të caktuara, nga fushat e Malësisë së Madhe e malet e gështenjave në Tropojë, deri poshtë në kullotat e ullishtat e brigjeve të Jonit, është vënë në lëvizje me sens të lartë përgjegjësie nga ana e qeverisë sonë dhe rezultatet konkrete, të një pune aspak të

lehtë që vazhdon, janë të padiskutueshme.

Ndërsa popullit grek i them, ejani në Shqipëri dhe do të ndjeheni si në shtëpinë tuaj, sepse pas një izolimi tragjik që na ndau për së gjalli për gjysëm shekulli dhe pas një tranzicioni dramatik me probleme të rënda e halle të mëdha, Shqipëria po bëhet çdo vit e më shumë një vend i mirë për të punuar, investuar, luajtur muzikë ose teatër, ekspozuar artin e kulturën tuaj të admirueshme apo edhe për të pushuar, në detet a në malet tona të magjishme. Po edhe sepse shqiptarët e grekët janë qysh në lindje të kohërave dy popuj miq, që gjeografia i ka bërë gjithnjë dhe historia i ka bashkuar për punët e për hallet e përbashkëta, shumë më tepër se sa i kanë ndarë politikanët për epshet e tyre për pushtet e për dallditë e tyre nacionaliste përgjatë rrugës gjarpëruese të historisë, në këtë rajon ku është prodhuar gjithnjë më shumë histori sesa kapacitete për t'i tretur prodhimet e historisë.

Ndërsa e sotmja na ka rifruar përgjithmonë, qoftë falë qindra mijëra shqiptarëve të dalë kockë e lëkurë nga bunkeri i varfërisë komuniste, që erdhën drejt jush në vitet e mundimshme '90 dhe tanimë janë bërë pjesë e jetës suaj në Greqi, qoftë falë gatishmërisë sonë për ta pasur gjithnjë të hapur derën për ju. Sepse ju jeni vëllezërit e motrat tona, me të cilët e ardhmja na bashkon pazgjdhshëmrisht, si dy popuj evropianë që dallojmë nga gjuha, por që duam s'duam, jemi siç thuhet në atë filmin e famshëm italian të Giuseppe Tornatores, "mia fatsa, mia razza".

***Thënie që i atribuohet
Shtatë të Urtëve të Greqisë**

Shqipëria sërish në krye të Këshillit të Sigurimit në OKB: Vendi ynë merr më 1 shtator për herë të dytë presidencën



Më 1 shtator, Shqipëria rimerr për herë të dytë Presidencën e Këshillit të Sigurimit në OKB.

Lajmin e ka bërë të ditur Ministria e Punëve të Jashtme dhe për Evropën, ku konfirmoi edhe një fjalë që do të mbahet nesër nga ministrja e jashtme, Olta Xhaçka.

Nga 1 janari 2022 Shqipëria u ul si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Më 11 qershor 2021 Shqipëria u zgjodh anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit për periudhën 2022-2023 duke shënuar një ditë historike. Shqipëria ishte vendi i vetëm nga ata që

ishin në garë që nuk kishte qenë asnjëherë anëtare e Këshillit të Sigurimit. Shqipëria bën pjesë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara që nga dhjetori i vitit 1955, me përfaqësues në Asamblenë e Përgjithshme. Zgjedhja në Këshillin e Sigurimit, për herë të parë pas 66 vitesh anëtarësim në OKB, përfaqëson sfidë madhore, por dhe një mundësi të shkëlqyer për Shqipërinë.

Shqipëria u paraqit si kandidaturë konsensuale e Grupit të Vendeve të Evropës Lindore. Veprimtaria e Këshillit të Sigurimit në Kombet e Bashkuara ka prioritet paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Në Lin të Pogradecit zbulohet vendbanimi më i vjetër në Europë

Arkeologë shqiptarë dhe zvicerianë gjetën këtë vit materiale të reja në kërkimet disavjeçare në Lin të Pogradecit të cilat flasin për vendbanimin më të hershëm liqenor në Europë. Sipas analizave laboratorike mbetjet e drurit të shtëpive të zbuluara në ujë datojnë rreth viteve 6000 deri në 5800 para Krishtit.

Në bregun shqiptar të liqenit të Ohrit, në Lin të Pogradecit, arkeologët shqiptarë dhe zvicerianë kanë hedhur dritë këtë vit për një vendbanim të ri liqenor që vlerësohet si më i hershmi në Europë.

Vendbanimi besohet se ka qenë me shtëpi të ndërtuara mbi shtylla druri ku strehoheshin 200 deri në 500 banorë.

Profesori i arkeologjisë nga Universiteti i Bernës në Zvicër, Albert Hafner është njëri nga bashkëdrejtuesit e misionit arkeologjik

Zoti Hafner thotë se “vendbanimi është disa qindra vjet më i vjetër se vendet e njohura më parë të banimit të liqeneve në rajonet e Mesdheut dhe Alpine”.

“Në njohuritë tona, është më i vjetri në Evropë,” i tha zoti Hafner agjencisë së lajmeve AFP.

Për arkeologun shqiptar Adrian Anastasi që prej shumë vitesh është marrë me këto kërkime dhe ka bashkëdrejtuar misionin e sivjetshëm arkeologjik vendbanimi është mjaft kompleks.

“Zgjedhja e këtyre njerëzve, e këtij komuniteti, për të ndërtuar me pilota është një ndërtim më kompleks, më i ndërlikuar, më i vështirë i cili duhet shpjeguar se përse këta njerëz zgjidhën këtë lloj arkitekture”, thotë ai.

Prof. Ilir Gjipali, arkeologu shqiptar në fushën e Prehistorisë, i cili i është bashkëngjitur ekipit i tha Zërit të Amerikës se analizat kanë



dëshmuar se vendbanimi është më i vjetri në Europë.

“Zbulimet këtij viti ashtu si edhe të vitit të kaluar provuan në mënyrë të plotë nëpërmjet analizave të ‘karbonit 14’ por edhe të dendrokronologjisë që ky është vendbanimi më i hershëm palafit në Europë duke i tejkalluar edhe vendbanimet e mëparshme që mendoheshin se ishin më të hershme për këtë lloj kategorie vendbanimi”, thotë profesori.

Arkeologët kanë gjetur rreth vendbanimit, një gardh rrethues mbrojtës me trungje të trashë pemësh dhe po shqyrtojnë se përse ishte nevojë e banorëve për fortifikime kaq të gjera për t’u mbrojtur.

“Neolitizimi është një periudhë kur njeriu njih bujqësinë dhe blegtorinë dhe futet në rrugën e qytetërimit të vërtetë, sepse ndërton banesa, qëndron në to, dhe nuk është si më përpara në periudhën e paleolitit dhe mezolitit që ai bredh pas ushqimit për të siguruar ushqimin. Tani ai zhvillon aktivitetin në këto vendbanime që u shëndërruan në qytet e ardhshme dhe në qytetërime ako-

ma më të të zhvilluara”, thotë prof. Ilir Gjipali.

Ekspediat e këtij vit është në vijim të kërkimeve që janë bërë në Shqipërinë juglindore, thotë më tej zoti Gjipali.

“Ekspedia e këtij viti është në vazhdim të kërkimeve që janë bërë në Shqipërinë juglindore e cila ka qenë shumë e pasur me vendbanime prehistorike, flas këtu për zonën e Korçës dhe Pogradecit. Në mënyrë të veçantë kërkimet dhe për vendbanimet palafite që janë vendbanime liqenore si janë ato të Pogradecit dhe të zonës së Korçës në ish liqenin e Maliqit të dikurshëm kanë dhënë të dhëna interesante që tregojnë për një aspekt tjetër të neolitizimit të territoreve shqiptare”, thotë ai. Ekspeditat arkeologjike pritet të vijojnë për të hetuar shtrirjen e vendbanimit, për të gërmuar në banesa dhe të tjera struktura që lidhen me mbrojtjen e vendbanimit. Sipas arkeologëve do kërkohen vite të tjera të kërkimeve nënujore për të krijuar më pas edhe mundësinë e ndërtimit të një muzeu që do të paraqiste zbulimet në këtë rajon.

A është përsëri zgjerimi në agjendën e BE-së?

Charles Michel
President of the European Council

In this photo provided by the Slovenian Government, European Council President Charles Michel speaks during the Bled Strategic Forum 2023 at the Bled Festival Hall in Bled, Slovenia, Monday, Aug. 28, 2023. (Daniel Novakovic/Slovenian Government Press Service via AP)



CRAIG TURP-BALAZS

Presidenti i Këshillit të BE-së, Charles Michel, këtë javë u ofroi kandidatëve për anëtarësim shumë fjalë të këndshme, por pak përmbajtje.

Furra buke në hotelin Park në vendpushimin malor slloven të Bled, ka bërë për më shumë se 70 vjet, kremna rezina e saj e njohur, një krem kremi dhe krem pana të rrahur, e njohur edhe si kremshnita. Më shumë se 10 milionë u janë shërbyer vizitorëve në tarracën e hotelit, i famshëm për pamjet e tij mbi liqenin Bled ashtu edhe për kafën dhe kekun e parezistueshëm të pasdites.

Variacione të “rezinës krem-

na” shërbehen në të gjithë ish-Jugosllavinë, por të gjitha përmbajnë një dozë bujare sheqeri pluhur të spërkatur sipër. Pjesëmarrësve nga shtetet e mundshme anëtare të BE-së në Forumin Strategjik të Bled të kësaj jave mund të falen që u larguan nga qyteti slloven me idenë se Charles Michel, presidenti i Këshillit Evropian, kishte qenë po aq bujar me shtresën e sheqerit që spërkati mbi shpresat e tyre për anëtarësim.

“Për të qenë më e fortë dhe më e sigurt, BE-ja duhet të përforcojë lidhjet tona dhe të bëhet më e fuqishme. Kjo është arsyeja pse tani është koha për të trajtuar sfidën e zgjerimit,” tha Michel audiencës së tij, e cila përfshinte disa kryeministra nga anëtarët e

mundshëm të BE-së, duke përfshirë Edi Rama të Shqipërisë dhe Ana Brnabić të Serbisë.

Michel shtoi se vendet me një perspektivë të konfirmuar të BE-së tani e tutje duhet të njihen si “shtete anëtare të ardhshme”.

“Është koha për të hequr qafe paqartësitë. Është koha për të përballuar sfidat me qartësi dhe ndershmëri. Rruga drejt BE-së për Ballkanin Perëndimor filloi më shumë se 20 vjet më parë. Një rajon në zemër të Evropës, i rrethuar nga BE. Ishte gjithashtu një rajon që doli nga konflikti pas shpërbërjes së Jugosllavisë”, tha ai.

Të dyja palët duhet të jenë gati deri në vitin 2030

Pesë nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë kandidatë për në BE: Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina. Përjashtim bën Kosova.

Ukraina dhe Moldavia u bënë kandidatë në vitin 2022. “I njëjti status pret Gjeorgjinë kur të përfundojnë hapat e nevojshëm,” tha Michel. “Zgjerimi nuk është më një ëndërr. Është koha për të ecur përpara.”

Duke pranuar se kishte ende “shumë punë për të bërë”, Michel tha se që BE të ishte “e besueshme”, duhej të kishte një axhendë dhe afat kohor të qartë për zgjerimin.

“Unë besoj se ne duhet të jemi gati – nga të dyja palët – deri në vitin 2030,” tha ai, duke theksuar nevojën që BE të rregullojë shtëpinë e saj. Presidenti francez Emmanuel Macron ka këmbëngulur prej disa vitesh se zgjerimi mund të ndodhë vetëm pasi BE-ja të ketë kryer vetë reformën e brendshme.

Duke folur në një mbledhje vjetore të ambasadorëve francezë në Paris, menjëherë pasi Michel kishte mbajtur fjalimin e tij në Bled, Macron paralajmëroi se, “Rreziku është të mendosh se mund të zgjerohemi pa reforma. Mund të dëshmoj se është mjaft e vështirë për Evropën të përparojë në tema të ndjeshme me 27 anëtarë. Me 32 ose 35 anëtarë, nuk do të jetë më e lehtë.”

Macron përsëriti gjithashtu idenë e tij, të shpallur për herë të parë në 2019, për krijimin e një “Evrope me shumë shpejtësi” në të cilën pjesë të ndryshme të Bashkimit Evropian duhet të integrohen në nivele dhe ritme të ndryshme në varësi të situatës politike në secilin vend individual.

Ukraina dhe Moldavia u bënë kandidatë në vitin 2022. “I njëjti status pret Gjeorgjinë kur të përfundojnë hapat e nevojshëm,” tha Michel. “Zgjerimi nuk është më një ëndërr. Është koha për të ecur përpara.”

Ideja nuk ka arritur të gjejë shumë mbështetje diku tjetër në blok, veçanërisht në mesin e vendeve anëtare në Evropën në zhvillim, të cilët kanë frikë se mos mbeten në margjina.

Zgjerimi do të mbetet i bazuar në merita

Udhëheqësit e BE-së do të diskutojnë zgjerimin në takimin e ardhshëm të Këshillit Evropian në Granada në Spanjë, i caktuar për në tetor, ku Michel ka të ngjarë të propozojë hapjen e negociatave të pranimit me Ukrainën dhe Moldavinë.

Kryeministri sloven Robert Golob, i cili gjithashtu foli në Bled, tha se përgatitjet e BE-së për anëtarësim “duhet të ndodhin në 12 muajt e ardhshëm ose nuk do të ndodhin për një kohë shumë të gjatë”. Kjo i bëri jehonë pikëpamjes së Michel se, “Dritarja e mundësive është e hapur. Ne duhet të veprojmë për të.”

Megjithatë, siç iu bë e qartë Ukrainës dhe Moldavisë vitin e kaluar pasi aplikimet e tyre u gjurmuan me shpejtësi për statusin e kandidatit, zgjerimi është

dhe do të mbetet një proces i bazuar në merita, shtoi Michel, duke theksuar rëndësinë e vlerave të përbashkëta dhe sundimit të ligjit.

“Sindikata jonë është e bazuar në vlerat themelore të drejtave të njeriut dhe dinjitetit, demokracisë dhe solidaritetit. Sundimi i ligjit siguron që ne mund të jetojmë, punojmë, krijojmë dhe tregtojmë në mënyrë të drejtë në një fushë të madhe lirish. Në respekt të plotë të diversitetit tonë. Në BE, çdo qytetar, çdo kompani duhet të besojë se do të trajtohen në mënyrë të drejtë – kudo që jetojnë apo bëjnë biznes. Kjo përfshin respektimin e të drejtave të pakicave.”

Michel e bëri të qartë gjithashtu se ai dëshiron të shohë ndryshime në procedurat e pranimit që do ta bëjnë të pamundur për anëtarët e rinj të bllokujnë vendet e ardhshme anëtare.

“Ne duhet të sigurohemi që konfliktet e kaluara të mos importohen në BE,” tha ai, në një vërejtje që nuk përmendi në mënyrë specifike Serbinë dhe Kosovën, por që synohej qartë të dëgjohej në të dy vendet.

Kryeministrja serbe Brnabić, e cila u përplas në Bled për statusin e Kosovës me kryeministrin e këtij të fundit, Albin Kurti, më vonë komentoi se Bashkimi Evropian shpesh vepronte sikur “çdo gjë që bën [Ballkani Perëndimor] nuk është mjaft e mirë”.

Edi Rama i Shqipërisë ishte gjithashtu skeptik, duke thënë se ai “e vlerësoi gjestin” e përcaktimit të vitit 2030 si objektiv, ndërsa pranoi se pranimi “mund të zgjasë shumë më shumë”.

Për të mbajtur të ëmbël Ballkanin Perëndimor, BE-së do t’i duhet qartë më shumë sheqer.

Paqja vetëm dëshirore! Ndryshoni kursin! Kambanat e Brukselit bien për Tiranën! Beleri midis Tiranës, Brukselit dhe Athinës! Të krahasosh të pakrahasueshmet!

REALPOLITIK FLASH NR. 73 | 1 - 16 GUSHT 2023 | EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Mbi 5 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, me vetëm 1.000 fjalë nga analisti i njohur, Mjeshtër i madh Dr. JORGJI KOTE



DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Paqja vetëm dëshirore! Më 5 gusht zyrtarë të lartë nga 40 vende të botës u mbledhën në Jedah të Arabisë Saudite për të diskutuar mbi një plan të mundshëm paqeje midis Ukrainës dhe Rusisë, ku kjo e fundit mungonte. Aty u fol mbi bazën e propozimeve për paqe/ armëpushim të Kinës, Brazilit, 7

vendeve afrikane dhe Zelenskit. Mirëpo, u ra dakord vetëm për faktin se sovraniteti dhe tërësia territoriale e Ukrainës është e paprekshme. Për asgjë tjetër. Gjithçka u la për takimin e ardhshëm. Mirëpo, faktikisht, paqja midis Rusisë dhe Ukrainës është vetëm dëshirë e mirë, asgjë më tepër. Ajo mund të realizohet vetëm kur Rusia të tërhiqet menjëherë nga territoret e pushtuara të Ukrainës, të zotohet me garanci praktike dhe ligjore se nuk do të ndër marrë më sulme të tilla,

duke i çelur rrugën negociatave të vërteta për paqen, siç ndodh në të tilla raste. Mirëpo kjo nuk ka gjasa të ndodhë siç po duken bathët. Ndaj, çdo propozim për armëpushim, ose paqe pa ndryshuar asgjë në statuskuonë e tanishme për Ukrainën nuk do të ishte paqe, por pushtim. Deri atëhere paqja do të mbetet vetëm "dëshirore" Po atëhere, lind pyetja, përse shpenzojnë kohë dhe energji kancelaritë perendimre dhe të tjerat? Në fakt, kjo është pjesë e "lojës politike" diku për

për konsum të brendshëm dhe të jashtëm politik dhe diplomatik, diku gjetkë për efekte zgjedhore, herë për protagonizëm gjeopolitik, sidomos nga Kina, Brazili, ndërsa të tjerët, sic i themi në shqip ”për t’u gjindur Kola në puë”.

bihet më shumë se sa duhet në qafë. ARGUMENTUM në këtë rubrikë dhe në shkrime të tjera ka pasqyruar dhe është shprehur në të njëjtat linja mendimi dhe veprimi. Është koha vërtet që BE dhe SHBA t’i japin fund naivitetit të tyre politik me



2.

Ndryshoni kursin! Ky është mesazhi që i dhanë Administratës së Presidentit Biden dhe BE-së në Letrën e tyre të datës 4 Gusht 10 kryetarë të Komisioneve të Jashtme të Parlamentit nga vende të mëdha europiane dhe Senatit të SHBA-ve si dhe 56 deputetëve të gjithë krahëve politikë. Çuditërisht memecllëk, asnjë prononcim nga Shqipëria! Siç është bërë e njohur, shkurt dhe troç ata kërkojnë që Perëndimi të mos i japë më kulaç por kërbaç Serbisë, jo më me politikë qetësuese por shtrënguese, jo me përkëdheli dhe Beogradin si ” të nënës ndërsa Prishtinën ” si të njerkes”. Dhe të kundërtën ndaj Kosovës si vend aleat dhe partner i Perëndimit të cilës po i

Beogradin se me politika të tilla qetësuese do ta mbajë atë larg Moskës. Përkundrazi, Beogradi po abuzon me zemergjerësinë perendimore; ndërkohë, nuk heziton t’i tregojë dhëmbët dhe ta sfidojë haptas BE-së dhe SHBA-të. Le të shpresojmë



se Perëndimi ”do t’i thërrasë mendjes” përpara se të jetë vonë. Ndonëse shenjat deri tani nuk janë premtuese.

Ndryshoni kursin! Ky është mesazhi që i dhanë Administratës së Presidentit Biden dhe BE-së në Letrën e tyre të datës 4 Gusht 10 kryetarë të Komisioneve të Jashtme të Parlamentit nga vende të mëdha europiane dhe Senatit të SHBA-ve si dhe 56 deputetëve të gjithë krahëve politikë.

3.

Kambanat e Brukselit bien për Tiranën! Të tilla janë konstatimet dhe qortimet e raportit më të fundit të Komisionit European të bërë publik më 7 Gusht mbi ecurinë e procesit të skanimit në kuadrin e negociatave tona me BE-në. Krahas disa elementve të veçuar pozitivë, raporti nënvizon të këqijat tashmë të njohura dhe të përhapura në çdo qelizë të

jetës në vendin tonë, madje dhe me fondet e vetë BE-së – korrupsioni, krimi i organizuar, informaliteti ekonomik, ndryshimi i shpeshhtë i ligjeve, klima e rënduar e biznesit, shkelja e lirisë së shtypit dhe medias, politizimi i administratës publike, ngadalësia dhe problematika në reformën e drejtësisë dhe plot të tjera. Madje, në disa fusha theksohet se jemi poshtë nivelit të mesatares së kërkuar për çeljen e negociatave. Për pasojë, nëse këto difekte madhore nuk riparohen brenda këtyre pak muajve të fundit, që ka shumë fare pak gjasa të ngjajë, rrezikohet seriozisht çelja e vërtetë e negociatave dhe në Janar 2024. Sepse tanimë nuk bëhet më fjalë për parime, deklarata të përgjithshme dhe detyra shtëpie, por dhe për detaje teknike dhe ligjore. Mirëpo, siç thonë me të drejtë, “djalli, sidomos me BE-në qëndron te detajet”!




4.

Beleri midis Tiranës, Brukselit dhe Athinës: Ajo çka u tha më lart bëhet dhe më e vërtetë kur sheh përshkallëzimin e Çështjes “Beleri”, Kryetari të zgjedhur të Bashkisë së Himarës, i cili mbahet prej 3 muajsh në paraburgim. Politika dhe diplomacia greke po i ngrenë tonët e polemikës, më 14 Gusht Kryetari i Bashkisë së Athinës, Kostas Bakojanis nga dinastia e Mitsotakis dhe ai i Selanikut ishin në

mitingun e protestës së zhvilluar në Himarë. Ashtu si deputeti Syrigas më 10 Gusht, Bakojanis paralajmëroi “furtunë” në procesin e integritit të vendit tonë në BE. Shihni strategjinë e re të zgjerimit dhe do të shihni se pasoja e menjëhershme e çështjes “Beleri” mund të jetë bllokimi i përkohshëm i negociatave dhe i fondeve të prag antarësim-it. Nëse politika jonë vazhdon me parimin “pushka bam dhe Muçua tutje” ka dhe më keq akoma dhe na rroftë sovranizmi. Pa hyrë në analiza, pala greke ka të drejtë për faktin se nga 31 raste, Beleri ishte i vetmi që u arrestua dhe vetëm dy ditë përpara zgjedhjeve; kryesorja, shkelet parimi i « prezumimit të pafajësisë », duke e mbajtur në paraburgim, kur fare mirë ai mund të hetohej në gjendje të lirë, siç ndodh në botën e qytetëruar. Ndaj, kërko-het veprim i shpejtë dhe i gux-

Nëse politika jonë vazhdon me parimin “pushka bam dhe Muçua tutje” ka dhe më keq akoma dhe na rroftë sovranizmi. Pa hyrë në analiza, pala greke ka të drejtë për faktin se nga 31 raste, Beleri ishte i vetmi që u arrestua dhe vetëm dy ditë përpara zgjedhjeve; kryesorja, shkelet parimi i « prezumimit të pafajësisë », duke e mbajtur në paraburgim, kur fare mirë ai mund të hetohej në gjendje të lirë, siç ndodh në botën e qytetëruar.

imshëm nga shumica jonë parlamentare, përpara se zullumi të trashet më tej.



5.

Të krahasosh të pakrahasueshmet! E kemi fjalën për memen e Kryeministrit Rama më 9 Gusht ku krahasohet eksodi i mijra shqiptarëve në Itali 32 vite më parë dhe “eksodi” turistik i mijra italianëve këtë vit në vendin tonë! Natyrisht që do të krjonte debate dhe zhurmë në shtetin fqinj dhe te ne. Për absurditetin e krahasimit. E para nuk i takon Kryeministrit tonë të bëjë krahasime të tilla; së dyti, kur flet për eksodin drejt Italisë duhet shprehur respekti për ata djem dhe vajza nënash, por mos harro se tani të kanë ikur qindra mijra, ndoshta 100 herë më shumë se atëhere! Ndaj të permendësh 9 gushtin 1991 është si të “kujtosh litarin në shtëpinë e të varurit”. Së treti, atëhere shqiptarët iknin “nga halli”, sot italianët po vijnë “nga malli” atëhere shqiptarët ikën për një jetë më të mirë e përgjithmonë, sot italianët po vijnë për disa ditë për turizëm. Ndaj, të krahasosh ato është si skeçi i dikurshëm i Estradës se Ushtarit kur mblidhnin kamionat me batalionat!

ATHINË, LIDERËT E BALLKANIT ME DEKLARATË TË PËRBASHKËT:

Vendi i Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin European!



Kryeministri Kyriakos Mitsotakis shtroi një darkë jozyrtare për nëntë liderë të Ballkanit, Presidenten e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen dhe kreun e Këshillit Evropian Charles Michel për të diskutuar të ardhmen evropiane të rajonit.

Darka u mbajt në 20 vjetorin e një samiti BE-Ballkani Perëndimor në qytetin e Selanikut, ndërsa shtetet e Ballkanit kërkuar t'i bashkohen bllokut.

Në këtë përvjetor u mbajt dhe një deklaratë e përbashkët.

Deklarata e përbashkët thekson se lufta ka “krijuar një nivel të ri të vetëdijes për parimet e përbashkëta, unitetin dhe një të ardhme të përbashkët brenda

BE-së” dhe se “nuk mund të ketë mosndëshkim për krimet e luftës dhe mizoritë e tjera, si sulmet ndaj civilëve dhe shkatërrimi” të infrastrukturës”.

Për më tepër, thuhet në dokument, “Ballkani Perëndimor, Ukraina dhe Republika e Moldavisë, gjeografikisht ngjitur me shtetet anëtare të BE-së, kanë një trashëgimi të përbashkët evropiane, një histori dhe një të ardhme të përcaktuar nga mundësitë dhe sfidat e përbashkëta”. “Si një investim strategjik për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Evropë, është e rëndësishme që këto rajone të mirëprehen si anëtarë të plotë të familjes evropiane”, thuhet në deklaratën e përbashkët.

Deklarata e përbashkët

Ne, Presidenti Aleksandar Vuçiq, Presidentja Maia Sandu, Presidenti Volodymyr Zelenskyy, Presidenti Jakov Milatović, Kryeministri Kyriakos Mitsotakis, Kryeministri Ion-Marcel Ciolacu, Kryeministri Albin Kurti, Kryetarja e Këshillit të Ministrave Borjana Kristo, Kryeministri Dimitar Kovachevski, Ministri Nikolai Denkov dhe kryeministri Andrej Plenkoviç, në prani të Presidentit të Këshillit Evropian dhe Presidentit të Komisionit Evropian, u takuam sot në Athinë, njëzet vjet pas Samitit historik BE-Ballkani Perëndimor në Selanik, dhe nxorëm këto deklaratë:

1. Pushtimi rus i Ukrainës



është një moment kyç për Evropën, duke krijuar një nivel të ri ndërgjegjësimit për parimet e përbashkëta, unitetin dhe të ardhmen e përbashkët brenda BE-së. Kjo është një kohë kritike për sigurinë, paqen dhe stabilitetin e kontinentit tonë evropian. Ligjet dhe parimet që kontribuuan në një rend sigurie të qëndrueshme dhe të parashikueshme evropiane për kaq shumë kohë janë shkelur dhe ne jemi dëshmitarë të shfaqjes së efekteve katastrofike.

2. Përballë agresionit rus, ne shprehim mbështetjen tonë të palëkundur për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht, bazuar në vlerat e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

3. Në diskutimet tona sot në Athinë, ne shprehëm mbështetjen dhe vlerësimin për përpjekjet e zellshme të Presidentit të Ukrainës Volodymyr Zelenskyy në përcaktimin e parimeve për paqen në përputhje me Kartën e OKB-së, në Formulën e tij të Paqes. Ne mirëpritëm gjithashtu përpjekjet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për një paqe

gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme në Ukrainë.

4. Ne ramë dakord se nuk mund të ketë mosndëshkim për krimet e luftës dhe mizoritë e tjera, siç janë sulmet kundër civilëve dhe shkatërrimi i infrastrukturës dhe të gjithë shkaktarët duhet të jenë përgjegjës.

5. Njëzet vjet më parë, Samiti i Selanikut pranoi se Ballkani Perëndimor i përket Bashkimit Evropian. Ne besojmë fuqishëm



Njëzet vjet më parë, Samiti i Selanikut pranoi se Ballkani Perëndimor i përket Bashkimit Evropian. Ne besojmë fuqishëm se sot kjo deklaratë mbetet më e rëndësishme se kurrë. Lufta e përshkallëzuar e agresionit kundër Ukrainës zbuloi nevojën urgjente për një BE të fortë, elastike dhe gjithëpërfshirëse si një gur themeli i paqes dhe prosperitetit midis popujve tanë gjatë këtyre kohërave sfiduese.



se sot kjo deklaratë mbetet më e rëndësishme se kurrë. Lufta e përshkallëzuar e agresionit kundër Ukrainës zbuloi nevojën urgjente për një BE të fortë, elastike dhe gjithëpërfshirëse si një gur themeli i paqes dhe prosperitetit midis popujve tanë gjatë këtyre kohërave sfiduese.

6. Sot në Athinë diskutuam rrugën për ta bërë realitet këtë vizion. Ne nënvizuam rëndësinë e vendosjes së vetes një objektiv për plotësimin e vizionit të një BE ku të jetë pjesë me Ballkani Perëndimor, Ukraina dhe Republikën e Moldavisë. Ne nënvizuam nevojën për një proces zgjerimi të ringjallur dhe të fokusuar që të jetë i prekshëm dhe i besueshëm. Ne shprehëm angazhimin tonë për të mbështetur Ukrainën dhe Moldavinë për të ndërmarrë hapat e ardhshëm në procesin e tyre të anëtarësimit sapo të kenë përfunduar reformat e nevojshme.

7. Ne besojmë fort se 20 vjet pas Samitit të Selanikut dhe në dritën e realitetit të ri gjeopolitik, ka ardhur koha për të miratuar një synim përfundimtar të guximshëm dhe ambicioz që do të shërbejë si udhërrëfyes, frymëzim dhe kontekst.

Der Spiegel: “Presidenti i Serbisë Vuçiç, zjarrvënës i Ballkanit”

